

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" në kuadër të projektit "SHAPE", zhvilloi aktivitetin sportiv të radhës në Kompleksin Sportiv "Shefqet Lamçja

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", në vazhden e aktiviteteve sportive, në kuadër të projektit SHAPE dhe Javës Ballkanike të Sportit, ka zhvilluar në Kompleksin Sportiv "Shefqet Lamçja" të qytetit të Elbasanit aktivitetin e radhës.

Nga sfidat e futbollit, volejbollit, e deri te garat argëtuese me thasë dhe vezë, të rinjtë pjesëmarrës treguan shpirtin e tyre garues dhe të ekipit.



